

PAISJE MBËSHTETËSE

- **DELL** - Desktopti lejon futjen e programeve që lehtësojnë aksesueshmërinë si lexuesit e ekraneve, zmadhimin e ekraneve, programeve që njohin zërin si komandë.
- **Dell NB Latitude**- Është një laptop që lejon shkarkimin e programeve që lehtësojnë leximin e teksteve në kompjuter, duke mbështetur personat me vështirësi të të parit.
- **Tablet - Kamvas** -Tableti mund të jetë I aksesueshëm nga personat me aftësi të kufizuara fizike apo ata me vështirësi të të dëgjuarit pasi lejon paraqitjen grafike të materialeve.
- **HeadSet** - Është një kufje profesionale që limiton zhurmat e mjedisit, me mikrofon të cilesisë së lartë e Bluetooth për studentët me problem të dëgjimit apo për një komunikim më të qartë audio, por edhe studentët me vështirësi fizike lëvizore.
- **HeadSet Plantronics** – Kufjet lejojnë komunikimin pa pasur nevojë të përdoren duart nga përsinat me vështirësi motorike. Po ashtu përshtatet me programe që kthejnë zërin në tekst apo lexon ekranin. Kjo paisje kufizuaon edhe zhurmat në mjedisin përreth.
- **Voice Amplifier** - Është një paisje që përdoret për rritjen e volumit të zërit sa më qartë e më lart, duke kapur zërin, lehtëson dëgjimin më qartë edhe në mjedis të zhurmshëm apo në largësi.
- **Conference System Polycom** - Ofron të parit e videove me rezolucion të lartë për studentët me vështirësi në të parë. Për studentët me vështirësi në të dëgjuar ofron lidhjen me paisje asistive të dëgjimit.
- **OrCam Read Smart** - Është një paisje që lehtëson leximit tek personat disleksik dhe tek ata me vështirësi në të parë. Lehtëson leximin e personave që kanë vështirësi në lëxim tradicional. Po ashtu transkripton dhe përkthen në kohë reale duke lehtësuar jo vetëm këtë kategori, por edhe kategori të tjera vështirësish të leximit në libër apo në ekrane digjitale, duke i dhënë mundësi të konvertojnë tekstin në zë e duke I dhënë personave lehtësi dhe aksesibilitet në lexim
- **Jouse+** - Është një paisje e avancuar, e cila shërben për personat tetraplegjikë. Komandon kompjuterin me anë të gojës, mjekrës apo gjuhës duke lehtësuar leximin në kompjuter apo celular.

<ul style="list-style-type: none"> • Book & Document - Është një paisje e dizenuar për të skanuar libra apo materiale të printuara, për t'i digjitalizuar duke i bërë të aksesueshëm për ta kthyer tekstin në zë, për personat me vështirësi dëgjimore apo duke lejuar zmadhimin e tekstit apo të shkronjave në kompjuter. Kjo i jep mundësi aksesimi disa kategorive të personave me vështirësi në të nxënë.
<ul style="list-style-type: none"> • 4K Video Camera – kamera Camcord mund të përdoret kryesisht nga personat me vështirësi motorike, pasi mund të komandohet me zë.
<ul style="list-style-type: none"> • Wireless Bluetooth Wearable Hands Free Mouse - Përdoren si një palë syze për të kontrolluar treguesin e mouse-it. Lidhen me telefonat celularë, kompjuterët, tabletët dhe televizorët inteligjentë përmes Bluetooth për të revolucionarizuar përdorimin e teknologjisë për personat me lëvizshmëri të kufizuar ose thjesht duan/duhet të përdorin tregues pa duar. Pajisja gjurmon edhe lëvizjet më të vogla të kokës për të lëvizur kursorin në përputhje me rrethanat
<ul style="list-style-type: none"> • Mouse Alternativ- I krijuar posaçërisht për të adresuar nevojat e përdoruesve të kompjuterit me kontroll të kufizuar të dorës, vështirësi në aftësitë motorike, koordinim të dobët sy-dorë, mungesë shkathtësie manuale dhe spazma të pavullnetshme të muskujve.
<ul style="list-style-type: none"> • Foot Switch- Mousi(Celësi) i këmbës është një mjet lehtësues për personat me funksion të kufizuar të dorës, p.sh personat me paralizë apo me dëmtim të gjymtyrëve të sipërme, të cilët mund të realizojnë detyra të ndryshme e të përdorin kompjuterin me këmbë.
<ul style="list-style-type: none"> • Etiketa për tastiera kompjuteri për të verbërit dhe personat me shikim të dëmtuar (Shkronja të zeza në sfond të verdhë
<ul style="list-style-type: none"> • HDE Large Print Tastierë me taste të mëdha lehtësojnë përdorimin e tastierës së kompjuterit nga personat me vështirësi në të parë.
<p>SOFTWARE TEKNOLOGJI MBWSHTETËSE</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Dragon Naturally Speaking – Është një aplikacion që kthen zërin në tekst të shkruar, i cili komandohet me zë. Personat mund të shkruajnë e-maile, kërkojnë në kompjuter apo të lundrojnë në internet, duke mos pasur nevojë të përdorin duart. • Ghotit Real Eriter & Reader - Është një software i dizenuar të asistojë personat me disleksi apo me problem të tjera që lidhen me përdorimin e gjuhës. Mund të kthejë tekstin në zë, duke lëxuar me zë përmbajtjen e një teksti në kompjuter.

- **Jaws Screen Reader** – Është një software I dizenuar për të konvertuar tekstin në zë për të lexuar tabelat, tituj dhe linqe. Ky aplikacion është më I përshtatshëm për personat me vështirësi për të lexuar apo parë.
- **ZoomText Magnifier/Reader**- është një aplikacion që I lehtëson lexuesit të zmadhojnë tekstet apo grafikët në kompjuter, duke e bërë më të lexueshme përmbajtjen. Po ashtu ofron lexues të sintetizuar për leximin e teksteve, përdorimin e kontrastit të ngjyrave sipas nevojave të lexuesit duke e bërë përmbajtjen lehtësisht të aksesueshme.
- **Fusion - Jaws and ZOOM Text** - është një aplikacion që lehtëson leximin e ekranit , kryesisht për persona me vështirësi në të parë, duke ofruar funksionin e kthimit të tekstit në zë si për përmbajtjet e materialeve, duke I lejuar aksesueshmërinë disa kategorive të vështirësive në të parë përmes zmadhimit të ekranit të kompjuterit dhe leximit të teksteve